

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AEK \$ Z GRUP INVESTMENT” SHPK**

**Neni I**  
**Emertimi i shoqerise**

Sot ne date 15/1/2022 , Z. Klevis Zaimaj i datelindjes 14.02.1987 i biri i Kamberit dhe Ardjanes me numer personal ID I70214057V me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur dhe banues ne Tirane dhe

Z. Kamber Zaimaj i biri i Faries dhe Hatemes i datelindjes 20.01.1960 me ID G00120397Q madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar banues ne Vlore, krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “AEK \$ Z GRUP INVESTIMENT” Shpk.

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”

**Neni 2**  
**Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise “AEK \$ Z GRUP INVESTIMENT” Shpk. Eshte ne Vlore Lagja Uji i Ftohte, Rruga “Konomaj”, objekti me nr pasurie 43/63 ND3-N1 ZK 8602. Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte jas. Shoqeria sipas parashikimeve te ketij Statuti dhe legjislacionit ne fuqi mund te hape ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj qendra dhe perfaqesi apo filiale, dege dhe shoqeri te tjera. Shoqeria fiton te drejten e personalitetit juridik nga data e rregjistrimit ne QKB.

**Neni 3**  
**Kohezgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete objekt i te drejtes shqiptare me nje afat te pacaktuar. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete subjekt me periudhe kohore te pacaktuar nga data e themelimit te saj, por me vendim te ortakeve mund te priset dhe para kohe.

#### Neni 4 Objekti

Objekti i shoqërisë do të jete si vijon :

Aktivitet ne fushen e ndertimit: Import eksport material ndertimi si dhe veprimtari prodhuese. Veprimtari ndertimi dhe projektim i banesave, hoteleri, resorte turistike, ndertim ujesjellesash, vepra arti bonifikuese, ura, basene ujore, ndertim impiante, ndertime portuale etj. Import eksport prodhime ushqimore dhe blegtorale me shumice e pakice duke hapur pike tregtimi, markate e supemarkete si dhe qendra frigoriferike per prodhime bujqesore dhe blegtorale. Veprimtari ne sektorin e prodhimit te energjisse se paster ujore dhe fotovoltoike. Veprimtari ne sektorin shendetsor: veprimtari sherbimi, import eksport pajisje, aparatura mjeksore, tregtim I tyre. Sherbime poliklinike, qendra laboratorike, sherbime spitalore dhe farmaceutike, sherbime rehabilituese dhe ndertim e sherbim i qendrave sociale

#### Neni 5 Kapitali i regjistruar

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri është 200.000 leke (dyqindemije) , numri i pjeseve eshte 2( dy) kuota .Pjesemarrja ne perqindje eshte sipas kontributit te ortakeve: Klevis Zaimaj 1 kuote ne masen 50% me vlere 100000 leke. Kamber Zaimaj 1 kuote ne masen 50% me vlere 100000 leke. Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te shoqerise .

#### Neni 6 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "AEK \$ Z GRUP INVESTIMENT " shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit nëkapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit

çdo mënyre tjetër të parashikuar ne ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen ne mbledhjen e asamblese te shoqerise ku te drejten e parablerjes e kane ortaket e shoqerise

#### Neni 7

## **Asambleja e Pergjithshme e shoqerise Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështjet e tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 8

#### **Mbledhja e asamblesë së përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligjet e tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të

ndërmjetme financiare, rezulton osekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshembrenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesëapo të disponojë në mënyrë tërë aktive, të cilat kanë njëvlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve tëpara pas regjistrimit të saj, propozon tëblejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtijneni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtijneni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtijneni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtijneni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi meshkresë ose, nëseparashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresëapo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditëpërpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtijneni, ajo mund të marrë vendime tëvlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuarnë statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve tëposaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe

sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, qëu njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

#### Neni 15

##### **Përfshirja nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 16

##### **Procesverbale të mbledhjes së asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendit të mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

#### Neni 17

##### **Drejtimi dhe administrimi**

Shoqeria tregtare “AEK \$ Z GRUP INVESTIMENT” shpk do te drejtohet nga nje administrator qe emerohet me vendim te Asamblese te Shoqerise.

Administratori i shoqerise per periudhen 5 vjecare duke filluar nga data e sotme deri me daten 20.04.2027 do te jete ortaku Z.Kamber Zaimaj i 20.01.1960 me numer personal G00120397Q

Administratori ka te drejte e te detyrohet te :

- Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare te vendosur nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.
- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paraqet keto perpara asamblea e përgjithshme e shoqerise per miratim,
- Krijon nje system paralajmerimi ne kohën e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
- Raporton para asamblese te përgjithshme e shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- Administratori do te shperblehet sipas percaktimit te asamblese se përgjithshme te shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

#### Neni 18

##### **Kontrolli i brendshem**

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar , i cil eshte pergjegjes perpara shoqerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne regull e detyres se tij

#### Neni 19

##### **Bilancet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim.Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te viti paseardhes

dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim asamblese se pergjitheshme te shoqerise.

Neni 20

### **Kohezgjatja e veprimtarise**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkak. Ne rast shkrirje para afatit te shoqerise, Asambleja e pergjitheshme e Shoqerise vendos mbi menytrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator duke i percaktuar dhe detyrat. Ne rast likujdimi emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim"

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723 dt.03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 21

### **Dispozitat perfundimtare**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asambleja e pergjitheshme e shoqerise.

Shoqeria "AEK \$ Z GRUP INVESTIMENT" SH.P.K do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur.

Ky statut neneshkruhet nga orataket e shoqerise

**Ortaket**

**Klevis Zaimaj**

KLEVIS ZAIMAJ  


**Kamber Zaimaj**

